



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 107, Datë 29.03.2021

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN
NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT KORÇË, PËR POZICIONIN E LIRË
NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 176,
DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 176, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e znj. Marçela Shehu, si relatore për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR